



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 122

Prishtinë, më 21.11.2024, në orën 09:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Adnan Rrustemi, Arijeta Rexhepi, Artan Abrashi, Besnik Tahiri, Blerta Deliu-Kodra, Dimal Basha, Driton Selmanaj, Erxhan Galushi, Hydajet Hyseni-Kaloshi.

Mungoi: Hajdar Beqa.

Mbledhjen e kryesoi Adnan Rrustemi, kryetar i Komisionit.

Pjesëmarrës të tjerë: Fjollë Haziri, KDI; Lumnije Murati, Presidenca e Republikës së Kosovës.

Stafi mbështetës i Komisionit: Fatbardha Boletini dhe Mirlinda Kolgeci.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 14.11.2024;
3. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore për Projektligjin nr.08/L-291 për Gjykatën Administrative;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Projektligjin nr.08/L-304 për bankat;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Projektligjin nr.08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 14.11.2024

Kryetari konstatoi se procesverbali i datës 14.11.2024, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore për Projektligjin nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative

Kryetari paraqiti për shqyrtim raportet e komisioneve kryesore për Projektligjin nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative dhe tha se Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në mbledhjen e mbajtur më datë 6.11.2024, shqyrtoi raportin me rekomandime për Projektligjin nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative dhe vendosi që Komisionit funksional t'ia paraqesë këtë rekomandim, se Projektligji nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative, përmban kosto shtesë buxhetore, por të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Gjithashtu, Komisioni për Integrim Evropian, në mbledhjen e mbajtur më 13.11.2024, shqyrtoi projektligjin me amendamente dhe vendosi që Komisionit funksional t'ia paraqesë këtë rekomandim, se Projektligji nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative, nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Ndërsa, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim konstaton se Projektligji nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Më tej, tha se formalisht po miratojmë raportin, pasi ne e kemi miratuar këtë raport dhe e kemi dorëzuar te komisionet e përhershme, për ta konstatuar nga këndvështrimi i tyre, këtë të fundit.

Driton Selmanaj u shpreh se nuk e di kur është miratuar raporti, duke pohuar se në mbledhjen e kaluar nuk e ka parë në agjendë që ka qenë ky raport, i cili nuk ka kaluar ende. Më tej, tha se e kemi kaluar vetëm në parim dhe është themeluar grupi i punës. Pra, sipas tij, raporti me amendamente për Projektligjin për Gjykatën Administrative, tani ka ardhur. Po ashtu, tha se është hera e parë që po e trajton, sepse ka analizuar me kujdes amendamentet dhe ka një vlerësim që është përmirësuar dukshëm, sidomos te çështja e dyshkallshmërisë, çështja që ka qenë për të e papranueshme dhe shumë e dëmshme. Sipas tij, mirë që është hequr, sepse tani është vetëm një shkallë, mirëpo ka nevojë për disa sqarime. Te kontestet e punës, neni 5, ku thuhet: “të gjitha kontestet nga marrëdhënia e punës mes personit fizik dhe organit publik, ose mes organeve publike përjashtuar ndërmarrjet publike.” Pyetja që shtron deputeti është në lidhje me përjashtimin e ndërmarrjeve publike. Çështja tjetër që ngrit z. Selmanaj është në lidhje me juridiksionin. Te juridiksioni i Gjykatës Administrative, nuk flitet fare për kontestet administrative, që lidhen me tatimet, doganat dhe çështjet që ndërlidhen me aspektin fiskal. Por, ndërkohë, pak më vonë, aty e parashihni themelimin e një “Departamenti Fiskal, me kompetencë për të vendosur për të gjitha konfliktet administrative për çështjet doganore, tatimore, tatimi mbi pronën e paluajtshme dhe çdo tatim ose kontribut tjetër të aplikuar në Republikën e Kosovës.” Ndërkohë, te neni 4 i Ligjit për Gjykatën Komerciale, thuhet: “Të gjitha kontestet tregtare dhe konfliktet administrative janë në kompetencë të Gjykatës Komerciale...”. Pra, pyeti: Pse i është marrë kjo kompetencë Gjykatës Komerciale dhe a kemi të drejtë me një ligj që lidhet me një materie tjetër, t'i marrim këtë kompetencë Gjykatës Komerciale?

Po ashtu adresoi edhe një çështje teknike te neni 3, pjesa që ka qenë “krijimi, zbatimi ose ndërprerjen e marrëdhënies së punës.” Fjala “krijimi” është bërë themelimi, duke thënë që marrëdhënia e punës krijohet, nuk themelohet. Themelimi ka një kontekst tjetër. Pra, deputeti

kërkoi sqarime në këto pika: përjashtimin e ndërmarrjeve publike, mospërfshirjen në juridiksion çështjet fiskale, ndërkohë që është menduar themelimin e një Departamenti Fiskal dhe marrja e kompetencës së Departamentit Fiskal të Gjykatës Komerciale, që me ligj të veçantë, i ka kontestet administrative që lidhen me çështjet fiskale.

Kryetari sqaroi se më datën 30.10.2024, është miratuar raporti me amendamente për Projektligjin nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative. Ka pasur edhe diskutim, por jo kaq të zgjeruar. Sipas tij, z. Selmanaj dhe z. Tahiri kanë folur. Në lexim të parë ka kaluar para katër muajve, kur ka qenë ministrja këtu. Më tej, tha se shkurtimisht do të konstatojë edhe për procesverbal se në nenin 8, pas paragrafit 6, të shtohet: “Kandidati për kryetar duhet të ketë shërbyer si gjyqtar në çështje administrative 5 vitet e fundit, në mënyrë të pandërprerë”. Lidhur me këtë, theksoi se ka ikur teknikisht gjatë formulimit.

Ndërsa, deputetit Selmanaj mund t’i jap përgjigje shkurtimisht, mirëpo nuk janë më relevante, sepse jemi në fazën finale. Arsyeja pse i kanë larguar ndërmarrjet publike është sepse konfliktet administrative për marrëdhëniet e punës janë konsideruar në raport me institucionet tipike publike shtetërore, jo me ndërmarrjet, sepse ndërmarrjet nuk janë në kuadër të Ligjit për zyrtarët publikë, që është miratuar. Edhe atje përjashtohen, kanë një lloj rregullimi të veçantë se si i rekrutojnë punëtorët, për arsye specifike të tyre, andaj nuk janë përfshirë.

Sa i përket konflikteve administrative që i janë marrë nga kompetenca e Gjykatës Komerciale, kryetari u përgjigj se ka qenë si ide se po themelohet një Gjykatë Administrative, ku do të akumulohen të gjitha çështjet administrative, edhe ato që janë të shpërndara, si në rastin konkret edhe te Gjykata Komerciale. Ka pasur shumë debat në grup të punës, pro dhe kundër në lidhje me atë që e tha z. Selmanaj, por në fund është vendosur të shkohet me këtë version.

Një element tjetër që u përmend kalimthi nga kryetari, është në lidhje me dilemën e krijimit apo themelimit të marrëdhënies së punës. Ka qenë propozim i juristëve që nocioni më adekuat është themelim, sepse kur lidhet kontrata, e themelon një lloj raporti. Ndërsa, krijimi i vendit të punës është më shumë e institucionit apo e legjislacionit. Themelimi është parë si nocion adekuat, andaj është përmirësuar, përfundoi ai.

Driton Selmanaj, tha se ndoshta nuk ka qenë në atë mbledhje, sepse edhe fjalimin e fundit që e ka pasur, e ka pasur në lidhje me dyshkallshmërinë. Po të kishte qenë ky amendament, deputeti shprehet se nuk do të kishte diskutuar. Andaj, ndoshta nuk ka qenë në mbledhje. Edhe trajtimin që e ka pasur bashkë me z. Tahiri, ka qenë se si po ndërtohet edhe një gjykatë tjetër, që është e ngjashme me Gjykatën Komerciale, në kuptimin e funksionimit të brendshëm dhe që është kundërkushtetues, andaj ishte shprehur se do ta dërgonte në Gjykatë Kushtetuese. Po ta kishte parë që është hequr shkalla e dytë, nuk do të kishte folur për shkëlqje të Kushtetutës. Si përfundim nga ana e tij, ka mundësi që raporti është miratuar kur nuk ka qenë aty.

Kryetari konstatoi se Komisioni, me gjashtë vota për dhe një kundër, miratoi raportin përfundimtar të projektligjit, me vërejtjet e paraqitura si më sipër, dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R a p o r t

Për Projektligjin nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Projektligjin nr. 08/L-304 për bankat

Kryetari, tha se Komisioni për Buxhet Punë dhe Transfere, ka paraqitur 13 amendamente për këtë projektligj. Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 76, paragrafi 8 të Rregullores, vlerëson nëse projektligji dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

Meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se me tetë vota për, u miratua raporti me amendamente dhe vendosi që Kuvendit dhe Komisionit funksional t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr.08/L-304 për bankat dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Projektligjin nr. 08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut

Kryetari, tha se Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, ka paraqitur 14 amendamente në Projektligjin nr.08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut. Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 76, paragrafi 8 të Rregullores, vlerëson nëse Projektligji dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

Meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se me tetë vota për, u miratua raporti me amendamente dhe vendosi që Kuvendit dhe Komisionit funksional t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr.08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Të ndryshme

Kryetari paraqiti dy çështje nga administrata: e para, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës ka kërkuar një takim urgjent në lidhje me Ligjin për pronën publike, dhe e dyta, është takimi në Shqipëri.

Dimal Basha, tha se e ka udhëhequr grupin e punës për Ligjin për pronën publike. Po ashtu, tha se është diskutuar, por nuk kemi kohë ta trajtojmë dhe është trajtuar brenda grupit.

Ndërsa, sa i përket vizitës, ideja ka qenë që në fund të vitit, të jetë një takim me komisionin homolog, por që nuk e di sa është e realizueshme, përfundoi kryetari.

Në këtë pikë nuk pati çështje tjera për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 9:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Adnan Rrustemi,
Kryetar i Komisionit
